



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.17.1-2018-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR AKADEMINË E DREJTËSISË
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, maj 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Akademisë së Drejtësisë, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Shefkije Beka Gërvalla (Udhëheqëse e ekipit) dhe Mexhit Ferati (Anëtar i ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Shkëlqim Xhema.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	15
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	20
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	23

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Akademisë së Drejtësisë për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 31/10/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Akademisë së Drejtësisë.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Kryesuesi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të AD-së gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Akademisë së Drejtësisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Akademisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Drejtori Ekzekutiv dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Këshillit Drejtues është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Akademisë së Drejtësisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga Akademia e Drejtësisë kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Rregullorja MF-02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Planin e Prokurimit për vitin 2018.

Në kontekst të PFV-ve, kemi identifikuar këtë mangësi, si në vijim:

Te neni 19 - Raporti për pasuritë jo financiare - pasuritë nën 1,000€ ishin nënvlerësuar për vlerën 4,295€, këto pasuri ishin shpalosur në PFV në vlerë 114,194€, mirëpo vlera e saktë e tyre ishte 118,489€.

Lidhur me PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur. Marrë parasysh çka u tha më lartë, me përjashtim të çështjes së pasurisë nën 1,000€, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi A1 Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të siguroj që me rastin e hartimit të PFV-ve informatat financiare për pasuritë prezantojnë vlerën e drejtë dhe të plotë të tyre. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit. Akademia e Drejtësisë ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Vlen të theksohet se procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) siç parashihet me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP).

Megjithatë, për institucionin sfidë mbetet vonesa në angazhimin e trajnuesve të përkohshëm si dhe prezantimi jo i saktë i pasurisë nën 1,000€ në PFV.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	799,451	735,295	606,355	516,769	438,994
Granti i Qeverisë -Buxheti	799,451	700,951	606,355	515,672	427,699
Donacionet e jashtme	0	34,344	31,257	1,097	11,295

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 64,156€. Ky zvogëlim është rezultat i reduktimit të grantit qeveritar për 98,501€ me vendime të Qeverisë, ku prej kategorisë së pagave dhe mëditjeve për kurse janë ndarë 26,501€, prej kategorisë mallra dhe shërbime 70,000€ si dhe nga kategoria e shërbimeve komunale 2,000€. Ndërsa kishte rritje nga donacionet e jashtme në vlerën 34,344€.

AD organizon trajnime për ngritjen e kapacitetit gjyqësor e prokurorial të Kosovës duke përfshirë edhe fushën e publikimeve dhe hulumtimeve. Disa aktivitete janë realizuar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar të cilët kanë mbështetur Akademinë e Drejtësisë në zbatimin e programeve

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

të veçanta. Përkrahja nga donatorët e jashtëme ka qenë në vlerë prej 34,344€, prej të cilave nga Këshilli i Evropës 13,369€, GTZ 10,609€ si dhe nga UNDP 10,367€.

Në vitin 2018, AD ka shpenzuar 82% të buxhetit final, me një ndryshim prej 1% më pak krahasuar me vitin 2017 që ishte 83%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	799,451	735,295	606,355	516,769	438,994
Pagat dhe Mëditjet	211,551	185,051	185,051	185,825	183,460
Mallrat dhe Shërbimet	560,400	524,744	398,520	310,945	245,783
Shërbimet komunale	14,500	12,500	9,904	10,258	9,751
Investimet Kapitale	13,000	13,000	12,880	9,741	0

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 26,501€ me vendim të Qeverisë për kursime buxhetore, ky buxhet ishte shpenzuar 100%. Kursimet buxhetore ishin për shkak se 3 (tri) pozita të lira gjatë vitit nuk ishin plotësuar, për faktin që deri në fund të vitit nuk ishte miratuar rregullorja për sistematizim dhe organizim të brendshëm të AD-së si dhe katër punëtoresh ishin në pushime të lehonisë;
- Buxheti final krahasuar me atë fillestar për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte zvogëluar për 35,656€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i kursimeve buxhetore për 70,000€ dhe rritjes prej donacioneve të jashtëm 34,344€. Shpenzimi ishte 76% e buxhetit final, pasi që një pjesë e aktiviteteve të planifikuara me buxhetin e AD- së, janë financuar nga donatorët e jashtëm;
- Buxheti final për komunalitë krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,000€ si rezultat i kursimeve buxhetore sipas vendimit të Qeverisë. Ndërsa shpenzimet për këtë kategori ishin 79% e buxhetit final; dhe
- Kategoria e investimeve kapitale nuk kishte ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe atij final. Në këtë kategori janë shpenzuar 12,880€ apo 99%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje për vitin 2018 ishte 185,051€, i cili ishte shpenzuar 100%.

Në kuadër të shpenzimeve për paga dhe mëditje përfshihen pagat e stafit të AD-së dhe pagesat për anëtarët e Këshillit Drejtues të AD-së. Numri i aprovuar i stafit për vitin 2018 ishte 25 pozita, ndërsa numri i të punësuarve në fund të vitit ishte 22 punonjës. Testimet tona shpalosen çështjen si në vijim:

Çështja A2² - Vonesa në angazhimin e trajnuesve të përkohshëm

Gjetja

Sipas nenit 24 pika 7 të Ligjit për Akademinë e Drejtësisë Nr.05/L-095, mënyra e përzgjedhjes së trajnuesve dhe mentorëve të përkohshëm përcaktohet me rregullore të miratuar nga këshilli drejtues përmes një procesi transparent dhe konkurrues. Ndërsa rregullorja e brendshme nr. 06/2017 për Trajnuesit dhe Mentorët e AD përcakton që Trajnuesit e Akademisë të përzgjidhen në bazë të një procesi të hapur dhe konkurrues përmes një shpallje publike. Trajnuesit në Akademi janë gjyqtarë, prokurorë, profesorë universitarë dhe profesionist të tjerë.

Akademia e Drejtësisë më dt.27/03/2018 ka bërë shpallje publike për zgjedhjen e trajnuesve të përkohshëm duke zhvilluar procedurat e thjeshtësuar të rekrutimit. Komisioni për vlerësimin e dokumentacionit ka dal me një raport për përzgjedhjen e trajnuesve të përkohshëm të AD-së ku prej 86 aplikuesve vetëm 6 prej tyre kanë plotësuar kriteret.

Kryesuesi i Këshillit të Akademisë, me dt.28/09/2018 kishte nxjerr vendim ku kërkonte dorëzimin e dokumentacionit shtesë nga aplikuesit të cilët nuk i kanë dorëzuar gjatë shpalljes publike. Me këtë vendim është kërkuar që të hapet një shpallje publike e re për aplikim. Shpallja e re publike ishte bërë me dt.24/12/2018, dhe ky proces vazhdon edhe gjatë kohës kur ne ishim në auditim (mars - 2019).

Për këtë arsye, AD kishte angazhuar trajnuesit e përkohshëm nga listat e mëhershme.

Rreziku

Vonesa në procesin e angazhimit të trajnuesve të përkohshëm dhe angazhimi i trajnuesve nga shpalljet publike të mëhershme kufizon konkurrencën dhe mund të ndikojë që shërbimet e pranuar të mos jenë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e AD-së.

Rekomandimi A2 Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të siguroj që procesi i angazhimit të trajnuesve të përkohshëm të kryhet me kohë, duke siguruar proces transparent dhe angazhim i tyre të bëhet vetëm nëse ata i plotësojnë kriteret e përcaktuara.

² Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë shërbimet komunale në vitin 2018 ishte 537,244€. Prej tyre janë shpenzuar 408,424€ apo 76% e buxhetit. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këto kategori përfshijnë shpenzimet e arsimit dhe trajnimit, shpenzimet e qerasë, shpenzimet e botimeve dhe publikimeve, shpenzimet e udhëtimeve për vizita studimore, shpenzimet komunale dhe të tjera.

Për këto shpenzime, ne kemi kryer testet tona dhe nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 13,000€, prej tyre ishin shpenzuar 12,880€ të cilat kanë të bëjnë me furnizim me pajisje të IT -së.

Për investimet kapitale, ne kemi kryer testet tona dhe nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PFV ishte në vlerë 15,097€, pasuritë jo-kapitale nën 1,000€ ishin në vlerën 114,195€ ndërsa stoqet 12,980€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës financiare Nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo

financiare të organizatave buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Dobësitë lidhur me këtë janë si në vijim:

Çështja B1 - Mos harmonizimi i regjistrit të pasurive jo financiare me raportin e inventarizimit

Gjetja Sipas nenit 18 të Rregullores së MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, OB duhet të bëjë inventarizimin e pasurive financiare, ndërsa sipas nenit 19, raporti i inventarizimit duhet të kryhet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që të krahasohet gjendja nga inventarizimi me gjendjen në regjistrat e pasurisë.

Përkundër rekomandimit të vitit të kaluar lidhur me pasuritë, AD ende nuk ka arrit ta bëjë harmonizimin e pasurisë që të ketë një regjister të plotë dhe të saktë të pasurisë. Komisioni i vlerësimit në vitin paraprak kishte konstatuar se tri asete (dy kompjuter dhe një printer të testuar) janë jashtë përdorimit (të asgjësuar në vitin 2014), dhe këto pajisje nuk ishin larguar nga regjistrat e pasurive deri më tani.

Edhe në vitin aktual komisioni kishte kryer me kohë inventarizimin, mirëpo raporti i pasurive nuk ishte harmonizuar me raportin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

Sipas AD-së, kjo çështje po përsëritet për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm.

Rreziku Mos harmonizimi i regjistrave të pasurisë ka ndikuar në mos largimin e gjithë pasurive që janë jashtë përdorimit nga këta regjistra, dhe e gjithë kjo ka ndikuar direkt në mbivlerësim të pasurisë së AD-së.

Rekomandimi B1 Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë që komisioni për inventarizim dhe vlerësim të pasurive përfundojnë detyrat e ngarkuar me kohe, dhe të bëjnë vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjithë pasurive jo financiare, si dhe të harmonizojnë raportin e pasurive me raportet e inventarizimit dhe vlerësimit të cilat i paraprijnë paraqitjes së të dhënave të sakta të pasurisë në PFV.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 2,202€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Arsyeja e mos pagesës ishte pranimi i faturave pas kalimit të afatit të zotimit.

Raportimi i obligimeve ishte bërë në përputhje me rregulloren nr.02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

AD në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

AD është në proces të zbatimit të rekomandimeve si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Për më tepër në vitin 2018, AD kishte aprovuar planin strategjik dhe rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Aty ku vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

Në bazë të kërkesave të parapara me U.A. nr.23/2009 për themelimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm, AD nuk i plotëson kriteret për themelimin e NjAB-së. Përkundër kërkesës që kishte bërë AD-ja në Njësinë Qendrore Harmonizuese në kuadër të Ministrisë së Financave (MF), gjatë vitit 2018 nuk ishte zhvilluar ndonjë proces i auditimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Procesi i raportimit të brendshëm në AD funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe strukturës organizative. Lidhur me këtë, Këshilli Drejtues / Drejtori Ekzekutiv mbajnë takime të rregullta, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet të përcjellura me procesverbale.

Po ashtu, ekzistojnë edhe raportimet tremujore financiare, si dhe raportimet sipas kërkesave ligjore.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 ka rezultuar me pesë rekomandime. AD-ja kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet, mirëpo nuk është zbatuar në tërësi. Nga pesë rekomandimet e dhëna, tri janë zbatuar plotësisht, (duke përfshirë theksimin e çështjes), ndërsa dy nuk janë zbatuar. Rekomandimet e pa zbatuara kanë të bëjë me dobësitë në mbulimin e pozitave me UD dhe dobësive në regjistrin e pasurive.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shih tabelën në vijim:

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojnë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PVF-ve në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e tyre nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në regjistrimin e pasurive.	AD kishte regjistruar asetet e pranuar nga donacioni. Këtë e kishte bërë në bashkëpunim me MAP-in gjatë vitit 2018.	I zbatuar.
2	3.2 Pagat dhe shtesat	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojnë se në rastet e shfrytëzimit të pushimit të lehonisë, kompensimet të bëhen në harmoni të plotë me kërkesat ligjore dhe të sigurojnë në bashkëpunim me MAP vendosjen e kontrolleve të shtuara për të parandaluar gabimet e identifikuara në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten.	AD ka informuar MAP për ndryshimet në pushime e lehonave dhe kjo çështje është rregulluar. Nuk kemi hasur raste të tjera.	I zbatuar.
3	3.3.Menaxhimi i personelit	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për zhvillimin e procedurave për mbulimin e pozitive të cilat po funksionojnë me ushtrues detyre (UD). Kohëzgjatja e funksionit si U.D të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore	Edhe këtë vit, kemi pozitën e Drejtorit të administratës dhe financave që vazhdon të mbulohet me UD.	I pa zbatuar.
4	3.6 Pasuritë Kapitale dhe jo kapitale	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet sigurojnë që komisioni për inventarizim dhe vlerësim të pasurive përfundojnë detyrat e ngarkuar me kohe, dhe bëjnë vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjithë pasurive jo financiare, si dhe harmonizojnë raportet e	Edhe përkundër që AD ka kryer inventarizimin me regjistri i pasurive vazhdon të ketë dobësi si nga viti i kaluar. Ky regjistër nuk është harmonizuar me raportin e inventarizimit.	I pa zbatuar.

		vlerësimit dhe inventarizimit të cilat i paraprijnë paraqitjes së të dhënave të sakta të pasuri në PFV.		
5	5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë aprovimin e strategjisë zhvillimore dhe një plan/proces të dokumentuar dhe efektiv të monitorimit të objektivave të përcaktuara.	Këshilli Drejtues ka miratuar Planin strategjik.	I zbatuar.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë që me rastin e hartimit të PFV informatat financiare për pasuritë prezantojnë vlerën e drejtë dhe të plotë të tyre. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		
2	Paga dhe Mëditje	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë që procesi i angazhimit të trajnuesve të përkohshëm të kryhet me kohë, duke siguruar proces transparent dhe angazhim i tyre të bëhet vetëm nëse ata i plotësojnë kriteret e përcaktuara.		
3	Pasuritë Kapitale dhe jokapitale	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë që komisioni për inventarizim dhe vlerësim të pasurive përfundojnë detyrat e ngarkuar me kohe, dhe të bëjnë vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjithë pasurive jo financiare, si dhe të harmonizojnë raportin e pasurive me raportet e inventarizimit dhe vlerësimit të cilat i paraprijnë paraqitjes së të dhënave të sakta të pasurisë në PFV.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Shtesa, Origj. Kop. Jedot. Orig. Letit	02	No. Prot. Br. Prot. Prot. No.	228
No. Faqave Br. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	07.05.2019
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës

Republika Kosova/Republic of Kosovo

Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Akademisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Aleksandër Lumezi

Kryesues i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë

Data: 07.05.2019, Prishtinë,